



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-29266/24
Kaçanik, 26.11.2024

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **X (dhjetë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VIII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 26.11.2024, në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteteve, me fillim pune në ora 11:00. Nga përbërja e përgjithshme e KPF, pjesëmarrës në mbledhje nga Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF ishin 7 anëtarë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Rustem Zenuni, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Edona Luzha.

Nga Ekzekutivi i Komunës në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari-Sabedin Vishi, Drejtorët e Drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Pranvera Loku-Zharku, Nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës ishin: Fatlume Guri-Selimi, Mavije Murseli, Makfire Malsiu.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Lartë për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësi, konstatoj kuorumin, pastaj e hapi mbledhjen e X (dhjetë) të rregullt të KPF-së për vitin 2024, data 26 nëntor, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Propozim Vendim për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e paluajtshme për vitin 2025;
3. Propozim Vendim për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2025.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 3 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes se kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së IX (nëntë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2024 të datës 21.10.2024/ Lënda: 01Nr. 060/01-26543/24.

2. Propozim Vendim për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e paluajtshme për vitin 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, drejtori është këtu, e hapi diskutimin:

z. Bahri Selimi: Normat të cilat janë në Propozim Vendim, janë të përcaktuara në ligj.

Kryesuesi i Kuvendit: A janë normat tatimore me të ulëta që i ka caktuar ligji?

z. Bahri Selimi: Normat të cilat janë në Propozim Vendim, janë me të ulëta të përcaktuara.

z. Agim Mani: Me ligjin e thirrur, qe po thoni se janë normat minimale, janë prej 10% deri 1% limiti, d.m.th. është shkuar në maksimum.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi: Jo, limiti është nga 0.10 deri në 1, maksimumi i normave tatimore është 1.

z. Bahri Selimi: Maksimumi i normave tatimore është 1.

znj. Ardita Rrahmani: Unë parimisht jam kundër ligjit që na ka obliguar me bërë këtë ngritje, por ne jemi të obliguar me zbatua ligjin.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi: Deri para 1 viti, norma minimale ka qenë 0.15, tani me ligjin e ri që ka shtuar vlerën e pronave të bizneseve, na ka mundësuar që në këtë pjesë ne me rënë me poshtë, që ne sado pak me e zbutur pjesën e tatimit të pronave që i kemi këtu, në 0.10.

znj. Ardita Rrahmani: A kemi ne ndonjë numër të pronave që kanë vlerë 5 milion euro.

z. Bahri Selimi: Komunitat e vogla besoj se nuk kanë prona me vlerë 5 milion euro. E keni vërejtur një përgjigje që ua kam kthyer pse ka ra vlera e TP, ka shumë shtëpi që nuk taten fare.

Kryetari i Komunës- Besim Ilazi: Pronat që kanë vlerë nën 30 mijë euro, nuk taten fare, janë afër 3 mijë prona, që për komunitat e vogla është dëm se bien inkasomi i tatimit në pronë.

z. Rrustem Zenuni: Kjo po i bien se Ligji i tatimit në pronë është në disfavor të komunitave të vogla.

Kryesuesi i Kuvendit: Si do që të jetë, akti që nxjerrët këtu, duhet të jetë në harmoni me ligjin, por mundemi me nxjerrë një akt që i referohet vlerave minimale të atij ligji, për shkak që mos me shkuar në vlera maksimale, që me i ngarkuar pronat e shtëpive të banimit dhe të bizneseve. Diskutime të tjera nuk ka, atëherë a jeni që kjo pikë të shkoj në KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF

Aprovoj

Propozim Vendim për caktimin e shkallëve tatimore progresive në pronën e paluajtshme për vitin 2025. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Vendim për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2025.

Kryesuesi i Kuvendit: Kjo pikë ka pasur mundësi mos me ardhur fare në KPF, megjithatë ka ardhur dhe po e shqyrtojmë. E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF

Aprovoj

Propozim Vendim për formimin e komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës, për vitin 2025. Ky Propozim Vendim i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 11:15. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët 07.

Mbledhja e 11 e Rregullt e Kuvendit të Komunës do të mbahet me 29.11.2024, në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfire Malsiu
MUMALSIU

